

PROBLEME DHE DISKUTIME

LIRAK DOBBIBA

VËREJTJE RRETH «RREGULLAVE TË DREJTSHKRIMIT TË SHQIPES» (Projekt)

S'ka dyshim se ky projekt i fundit i drejtshkrimit të shqipes është një hap i madh përpara drejt njësimi të gjuhës sonë të shkruar. Është bërë një përpjekje e madhe për të vënë rregulla të përpikta dhe për të njësuar në një trajtë të vetme fjalë që deri dje shkruheshin në mënyra të ndryshme. Këto përpjekje njësimi dhe njëtrajtësimi janë bërë, me të drejtë, në pajtim me zhvillimin e gjuhës letrare, në bazën e disa trajtave të përbashkëta, për të arritur në perspektivë në një gjuhë të vetme kombëtare të shkruar. Megjithatë projekti i ri, i parë më fort në prizmin praktik se sa në atë thjesht gjuhësor teorik, paraqet disa të meta që mund të përmbliken në këto pika:

1) Vende-vende ka rregulla të tepërta, p.sh. shkrimi i ë-së patheksore, ndarja e fjalëve në rrokje, shkrimi i fjalëve bashkë e ndaras etj.

2) Aty-këtu ka përjashtime që mund edhe të mënjanoheshin.

3) Ka zgjidhje çështjesh pa rregulla të plota, me anë shembullash; këto zgjidhje me anë shembullash nuk ndihmojnë, posa gjendesh përpara rasash që s'përmenden në «Rregullat». Pajtimi i mbiemrave me emrat mashkullorë me shumës me e, shkrimi i emrave të përveçëm greko-latinë, shkrimi i mbiemrave më -ët ose me -të etj.

4) Disa zgjidhje nuk më duken praktike (Ndarja e fjalëve në rrokje, shkrimi i emrave të huaj ashtu si shqiptohen, shkrimi i shifrave romake pa njëj, etj.).

Këto të meta, në qoftë se mund të quhen kështu, po i parashtrojmë me hollësi këtu duke ju mbajtur rendit sipas të cilit janë dhënë në «Rregullat».

Veç foljeve *fle* dhe *ndej*, në §2 f. 8 duheshin shtuar edhe *ngre* e *ve* (*vura*, *vënë*, urdh. *verë*) dhe jo *vë*, *vura*, *vënë*, *vërë*, ku trajtat *vë* dhe urdh. *vërë* më duken të kufizuara në përdorim dhe nëndialektore.

Për hir të §8 (f. 8) duhej parapëlqyer trajta i, e *gjërë* ndaj trajtës i, e *gjerë*, në pajtim me kalimin geg. *â* > gj. let. *ë*.

Dihet se emrat femërorë më e të patheksuar eptohen në dy mënyra: me rënje të e-së (*lule*, *lulja*, *lulje*), dhe pa rënje të e-së (*lule*, *luleja*, *luleje*). Në vend që të merrej për thjeshtësi njëra nga këto dy mënyra, është marrë emërorja e shquar nga mënyra e parë (*lulja*), dhe dhanorja e pashquar nga mënyra e dytë (*luleje*); zgjidhje kjo që s'na duket aspak praktike (§ 3, f. 8).

Tek emrat femërorë më -je (si *anije*, *lutje*, *kapje* etj.) trajtat *anijeje*, *lutjeje* etj., megjithëse të përdorura, mendoj se janë më tepër rindërtime të gramati-

kanëve, sepse në të folur emërorja e pashquar dhe gjindorja e pashquar janë një; ato trajta më *-je* s'ka si të jenë, gjersa s'ekziston as trajta *anijeja, lutjeja*, që mund t'i përligjte (§3, f. 8, kryerrj. i tretë).

Përsa i përket shkrimit të *ë-së* së patheksuar (BI, §6, f. 9, 10) në bazë të shqiptimit të përgjithshëm; do të kishte qenë mirë të shkruheshin pa *ë* edhe disa fjalë të tjera si *arsye, arsim, arsimtar, arsej, antar, antarësi, pjestar, pjestim, pjestoj, puntor, puntoria, tregtar, tregtoj, tregti, kallzim, kallzues, kallzoi, pyllzim, pyllzoi*, duke u kufizuar vetëm në këto fjalë, të cilat sot për sot kështu shqiptohen, dhe duket se kjo është edhe udha e vetë zhvillimit të gjuhës letrare.

Më duket se ka mospajtim kur caktojmë *i vogël, i vogli, të voglin dhe vogëloj* me *ë*, kurse *i pastër, i pastrë, të pastrin* bën *pastroj* pa *ë*; dy trajtat *vogëloj* dhe *pastroj* mund të njësoheshin në *vogloj* dhe *pastroj*. Si rregull mund të caktohej që, kur në lakimin e emrit dhe të mbiemrit bie *ë-ja*, kjo *ë* duhet të bjerë edhe në rrjedhonjat (derivatet); kështu, meqë është lejuar të shkruajmë *i shtrembri, e shtrembra, të shtrembrit*, folja duhej të ishte *shtrembroj*; po kështu duhej bërë edhe *poshtroj* dhe jo *poshtëroj*, siç është bërë edhe *vjetroj* dhe jo *vjetëroj*.

Për dhanoren e shumësit të mbiemrave jepen këto shembulla: *të ëmbëlve, të vegjëlve, të ashpërve, të pastërve, të shtrëmbërve, të vjetërve* (BI, §9, pika 1), kurse në pikën 3 thuhet se, në mbiemrat më *-ëm, ë-ja* del pas *m-së*. Kështu. krijohej një inkonsekuençë e panevojshme. Kur themi të *të pastërve, të ëmbëlve, të vjetërve* etj. përse s'u thënkua edhe *të vetëmve, të sotëmve, të atjeshëmve* dhe të mos kishim dy rregulla, duke krijuar dy kategori mbiemrash, ku njëra e ndërrohet vendin e *ë-së* dhe tjetra jo?

Lista e emrave mashkullorë më *-ë* si *djalë, kalë, lumë* etj. është mirë të jetet e plotë; do t'ishte e gjatë, por jo më e gjata. kësosha gjenden plot në «Rregullat» (BI, §10, pika 3, f. 17).

Thuhet se tek emrat asnjans në shumës ruhet *ë-ja* e patheksuar: *brumë-ra, djathë-ra, dhjamë-ra* etj. Kjo *ë* e patheksuar del edhe tek emra që s'e kanë këtë *ë* as në emëroren e pashquar të njëjstit si në *bar-ëra, elb-ëra, fund-ëra, qelb-ëra, lëng-ëra* etj., por nuk shkruhet në *mish-ra, vaj-ra, lesh-ra, mall-ra*. Nuk do të ishte më mirë të ruhej mbaresa *-ëra* edhe për emrat mashkullorë që marrin mbaresën e asnjansve *-ra*, se sa të thonim se *ë-ja* u shtohet emrave që mbarojnë me një grup bashkëtingëlloresh, ndër të cilat e fundit është e zëshme. Kjo bëhet edhe më e vështirë po të dimë se në shkollat tetëvjeçare s'bëhet dallimi i bashkëtingëlloreve në të zëshme e në të shurdhëra; i vetmi përjashtim do të ishte për emrat më *r* për të mënjauar bashkimin e dy *r-ve*, sepse *barëra* do të bënte *barra* (BI, §10, pika 4 dhe shënimi 1, f. 18).

Nuk kuptohet përse në «Rregullat» miratohet forma dialektore *lëngëra*, duke qenë si formë më e përgjithshme *lëngje*. Ndoshta për arësye stilistike. Mirëpo me këtë argument mund të përligjen edhe forma dialektore të tjera që s'duhet të prekeshin këtu.

Shumësi i natës bën *net* (*net-ët*), dihet; po dhe i ditës bën *dit* (*dit-ët*), përse ky përjashtim? Përse *ditë-t* me *ë*? Këto dy fjalë shqiptohen me *e* dhe i të shkurtër; si njësi mase të kohës, të javës, të muajit dhe të vitit, hyjnë ndoshta në atë kategori emrash, disa nga të cilët në shumës nuk marrin mbaresë të shumësit, si *gram, kuintal, pash* etj. Për mendimin tim, fjalët *ditë* dhe *natë* në shumës të pashquar duhen shkruar pa *ë*: *dy dit e dy net* ose *dy net e dy dit*.

Tek mbiemrat që herë janë shkruar me *-ët* dhe herë me *-të* janë krijuar shumë grupe që e vështirësojnë punën e të shkruarit; megjithëse në pozita fonetike të ngjashme, propozohet nga një anë i *saktë* nga ana tjetër i *rumbullakët*, i *cekët*; nga një anë i *kërpët* nga ana tjetër i *hapët*; nga një anë i *elbtë* nga ana tjetër i *kalbët*, i *dobët*. Zhvillimi i deritashëm provon se *ë-ja* e patheksuar e kësaj prapashtese anon të dalë përpara *t-së*, ashtu si del edhe përpara në emrat

me mbaresë më -ël, më -ër, më -ëz; në mbiemrat më -ëm; në mbaresat e aoris-tit në tri vetat e shumësit -ëm, -ët, -ën; vetë «Rregullat» propozojnë *bukël, ve-gël, kokërr, hënës*, në kundërshtim me trajtat e dikurshme *buklë, veglë, kokrrë, hënzë*; po kështu propozohet i *fisëm*, i *mesëm*, i *ndershëm* dhe jo i *fismë*, i *mesmë*, i *ndershmë*; caktohet *humbëm, humbët, humën* dhe jo *humbmë, humbtë, humb-në*. Kjo prirje e zhvillimit të gjuhës së sotme letrare është marrë parasysh ve-tëm për gjysëm.

Për mendimin tim problemi i shkrimit të mbiemrave më -ët ose -të është vetëm fonetik, kurse «Rregullat» kanë përcaktuar mënyrën e shkrimit duke u nisur nga konsiderata morfologjike: mbiemrave që rrjedhin nga emra e ndaj-folje u është dhënë mbarësia -të, atyre që rrjedhin nga foljet mbarësia -ët (pa e thënë këtë shprehimisht (BI, § 11), jo pa krijuar ngatërresa si p.sh. i *rrumbu-llakët* (duhesh i *rrumbullaktë* nga ndf. *rrumbullak*); *qelb* është dhe emër edhe folje atëhere edhe i *qelbtë* edhe i *qelbët*, po kështu del problemi edhe për *ndryshk* që është edhe emër edhe folje. Po për *lëng* do të shkruajmë i *lëngtë* apo i *lëngët* (Fj. I i *lëngët*)? Konkretisht për punë të prapashitesës -ët rregulla duhej shpre-hur në mënyrë që të mbizotëronte kudo trajta më -ët; gjithë këto mbiemra duhet të shkruhen: i *sakët*, i *rrumbullakët*, i *cekët*, i *kërpët*, i *hapët*, i *elbët*, i *kalbët*, i *dobët*, etj.

Këto mbiemra duhet të shkruhen me -të vetëm në rast se para -t-së kemi *f, th, sh, h*, të thjeshta: i *athtë*, i *shkathtë*, i *aftë*, i *sheshtë*, i *leshtë*, i *preshtë*; i *ngrohtë*, i *ftohtë*; ose kur para -t-së vjen një bashkëtingëllore e lëngët (*l, m, n, nj, r, rr*): i *çeltë*, i *mettë*, i *naltë*, i *rëndomtë*, i *komtë*, i *thantë*, i *miliontë*, i *thonj-të*, i *drunjtë*, i *artë*, i *thartë*, i *lartë*, i *errtë*, i *pjerrtë*, i *zjarrtë* (BI, §10, pikat 5, 6 dhe BI, § 11, pika 1).

Fjala *element* na del me dy shumësa, një me -e, kur tregon sende, gjëra pa frymë, dhe një me -ë, kur tregon frymorë. Ky dyfishim trajte është artificial dhe pa vend; një trajtë e tillë dyfishe mund të dalë edhe për *talent, talente* dhe *talentë* (njerëz të talentuar) dhe për plot fjalë të tjera si këto. Këto trajta dy-fishe artificiale janë krijuar nga që akordi i mbiemrave me emrat që dalin në shumës me e sikur s'tingëllon mirë, p.sh. *elemente të rrezikshme* s'u thënka për njerëz, po *personalitete të shquara* u thënka (BI, §10, pika 9, f. 19). Shih edhe vërejtjet për DI, §4, f. 63 më tutje.

Fjalët *direkt fishek, gjilpërë, gjilpëryer, hipi, krimb, rrip, qurre* duhen shkruar me *y*, sepse nën ndikimin e gegërishtes kështu shqiptohen nga shumica. Edhe fjalët *burokrat, burokraci*, që janë rrjedhona (derivate) të fjalës *byro*, duhen shkruar me *y*, *byrokrat, byrokraci*; s'mund të pranohet argumenti se kështu ja-në përdorur; roli i Institutit s'mund të jetë vetëm regjistruer, po më fort dhe kryesisht normativizues dhe njësuës në bazë kriteresh shkencore. Po kështu është bërë edhe *tranzit* me *z* (nga lat. *trans-itus*, nëpërmjet gjuhëve neolatine), kurse fjalët e tjera me parashtesën *trans-* duhen shkruar me *s*: transfuzion, transatlan-tik etj. (BI, §13, §14, f. 29, 30 dhe ÇI, pika 30, f. 61).

Për apostrofin (BIII, §1, f. 33, 34, 35) është me vend vetëm §1. Në paragra-fin e dytë miratohet hiatusi, e përse? Sepse u dashka ruajtur njësia e trajtave në të gjitha përdorimet e tyre, pavarësisht nga shqiptimi. Ky argument nuk vlen, veçan për shqipen, me një eptim (fleksion) aq të gjerë që ka (lakim, formim shumësi dhe gjinije, zgjedhim, veç apofonisë dhe metafonisë). Si mund të fli-tet në shqip për ruajtje trajtash kur themi dhe shkruajmë i *vogël, i vogli, të ve-gjëlit, i madh, të mëdhenj, vajza, vajze, vajzë* etj. Falë prirjes për apostrofim, mosdurim të hiatusit, në shqipe janë krijuar fjalë si *mënjane* (më një anë — më nj'anë), *ndanë* (nd'anë), *anëmbanë* (an'e mb'anë) etj. Me ndalimin e apostrofi-mit, në kundërshtim me vetë natyrën e gjuhës, prishet harmonia e frazës; shkrim-tari s'mund t'i japë frazës atë ecuri që i duhet për shprehjen e ritmit, dhe ky ri-

tëm lihet në dorë të lexuesit, i cili e paska të vështirë të kuptojë që te *vajz'e urtë* mungoka një zanore, po qenka i zoti të kuptojë vetiu se si ta këndojë frazën *vajzë e urtë*. Gjuha e folur s'e duron hiatusin: populli thotë: *n'iktë, n'ardhtë, në shtëpin'e madhe*. Veç kësaj apostrofin e kanë përdorur gjithë shkrimtarët nga Rilindja gjer më sot, si poetët dhe prozatorët. Ky paragraf i «Rregullave» shkel pra fonetikën sintaktike të gjuhës, kur ndalon apostrofin; megjithatë apostrofimi s'mund të bëhet edhe i detyrueshëm, kjo do të ishte po aq gabim sa edhe ndalimi i tij; apostrofimi duhet lënë i lirë, që të mund, ai që shkruan, t'i japë frazës atë ecuri që ja kërkojnë rrethanat ose nevojat e stilit. Nuk duhet lejuar vetëm në poezi gjithashtu, se do t'i hapnim shteg formimit të dy drejtshkrimeve paralele, një për poezinë krejt të lirë, dhe një për prozën plot pengesa.

Meqë bëhet fjalë në § 3 të apostrofit, do të propozoja që kallëzorja e përemrave vetorë *ky, ai* të shkruhen me *e, këte, te, ate* dhe jo *këtë, të, atë*; përpara fjalish si *erdhi për të, erdhi me të*, shpesh duket sikur ndodhemi përpara frazash të cunguara, të paplota, sikur mungon dishka: *erdhi për të* (biseduar), *erdhi me të* (shpejtë); për ta përligjur, mund të vlejné po ato arësye për të cilat *flë* është bërë *fle*; geg. dialektore *atë*, tosk. *atë*, trajtë e përbashkët *ate* (BIII, §3, f. 35).

Grupi zanor *ua/ue* duhet shkruar i plotë, sipas «Rregullave»: *mua, muej* dhe jo *muj.. ndërtues, sulmues*, dhe jo *ndërtus, sulmus*, por *paga mujore, tremujori i parë* etj. Është e vërtetë se ashtu shqiptohen; po edhe *ndërtues, sulmues* shqiptohen *sulmus, ndërtus*; përse atëhere të bëhet përjashtim vetëm për *pagën mujore* dhe *tremujorin*; prandaj mendoj se duhet shkruar pa përjashtim: *rrogë mujore, tremujor*, ose edhe më mirë *pagë muajore, tremuajor i parë* (BII, §8, f. 33).

Heqja e theksave, sidomos e theksit hundor, është me vend, por jo heqja e çdo theksi, në çdo rasë.

Një shteg për përdorimin e theksit e kanë hapur vetë «Rregullat», kur porosisin që emrat e huaj të përveçëm të shkruhen ashtu si shqiptohen; në këtë rasë s'ka si lihen pa theks; si do t'i shqiptojmë, kur do t'i theksojmë fjalët *Mikelanxhelo* dhe *Ruso: Mikelanxhelo* apo *Mikelánxhelo, Rúso* apo *Rusó* etj. Në këso fjalësh theksimi është pjesë e pandarë e shqiptimit, prandaj duhet vënë doemos. Po edhe në shqipe del nevoja e shënimit të theksit dinamik tek fjalët shumëerokshe oksitone, në njëjës e në shumës të pashquar, si në *bari* për të dalluar nga *bari*, *drejtori* për ta dalluar nga *drejtori*, *rrufë* nga *rrufe*, *kuti* nga *kuti* etj. (CI, §1, f. 35).

Shumësi i fjalës *thelb* bëka *thelpinj*. Përse ky përjashtim? Ky përjashtim përligjet ndoshta duke thënë se kështu shqiptohet: po edhe në njëjës ashtu shqiptohet *thelp, elp*; mirëpo për hir të njësimi të trajtave shkruhen me *b*; ky argument duhet të vlente edhe për shumësin; pra *thelb, thelbínj*, s'ka asnjë arësye për të bërë përjashtim.

Një përjashtim, lëshim ky që i bëhet morfologjisë, është edhe *këndes, këndesi*; shumica thonë *këndez, këndezi*; edhe këtu s'ka vend e arësye për përjashtim (C, §2, f. 37, shen. 1 dhe 2).

Tek parashtesat *s*, në kundërshtim me përdorimet dialektore, me parimin fonetik, pranohet se kjo *s* transformohet në *z* përpara bashkëtingëlloreve të zëshme; mënjanoheh kështu me të drejtë variantet dialektore *c* dhe *x*; nga katër *s*, *c*-, *z*-, *x*-, mbeten vetëm dy *s*- dhe *z*-. Sa mirë do të kishin bërë autorët e «Rregullave» sikur edhe parashtesat *sh*-, *ç*-, *zh*-, (*xh*-) t'i kishin sjellë në dy, *sh*- dhe *ç*-, duke përcaktuar pa përjashtime se me cilat bashkëtingëllore do të përdoret *ç*- dhe me cilat *sh*-; do të shkelej vërtet parimi fonetik, por as më shumë as më pak se ke *thelb, brez, elb, urov, qelb* etj. Ja edhe një rregull që do të na pakësonte shikimin e fjalorit drejtshkrimor orë e çast, e sidomos për rastet që mund t'i kenë shpëtuar «Rregullavet» (CI, §2, §3, f. 37, 38).

Emrat me *i* fundore të theksuar si *Shqipëria, bukuria, dituria, dashuria* shqiptohen me *j* (Shqipërija etj.). Shkrimi i tyre pa *j* që po praktikohet prej më se 10 vjetësh e rekomandohet nga «Rregullat e drejtshkrimit» vjen në kundërshtim me gjuhën e folur dhe është për t'u rishikuar. Analogjia me fjalët *kalaja, rrufeja, gjëja, byroja, druja, (të) dyja* etj. do të bëjë që ajo *j*, që ngatërron të mëdhenj e të vegjël, të vazhdojë të ndihet e të ndjellë në gabim. Nëse ngul këmbë e bëj për hir të thjeshtimit e të pakësimit të rregullave e të përjashtimeve; këtu shkelet parimi fonetik duke e larguar drejtshkrimin nga një normë e fonetikës popullore që s'ka e as duron përjashtime: *emrat femërorë që në trajtë të pashquar mbarojnë me zanore të theksuar, kur shquhen, para njëjës e marrin një j eufonike*. S'po zgjatet më për të mbrojtur parimin fonetik, për një ortografi me sa më pak rregulla dhe përjashtime, për një ortografi masive.

Tek emrat mashkullorë *-o* të patheksuar trajta e shquar më *-ua* është e rrallë dhe jo e gjithë dialekteve jugore, kurse trajta më *-ja* është më e përgjithshme, arrin gjer në Shqipëri të Mesme; prandaj duhen miratuar vetëm trajtat *balaja, Koçoja, pakoja, tornoja, radioja* etj. dhe duheshin nxjerrë jashtë përdorimit trajtat *balua, Koçua, pakua, tornua, radiua* etj. (CI, §4, pika 3, f. 40).

Ja edhe një inkosekuencë tjetër lidhur me tingullin *j*, *Shaljan, matjan, hotjan* etj. shkruhen me *j*, kurse *italian, brazilian* etj. shkruhen me *i* (*an*); s'ka dyshim që ndodhemi përpara së njëjtës prapashtesë shqipe *-jan*; tek *shaljan* ka rënë ë-ja e fjalës *Shalë* dhe rrënjës *shal-* i është shtuar prapashtesa *-jan*; tek *matjan* prapashtesa i është shtuar drejtpërsëdrejti rrënjës: edhe te *italian*, mbaresa *-jan* i është shtuar rrënjës (apo temës) *ital-*, duke i hequr *i-në*, si *ë-në* te *Shalë*. Edhe *brazilian* duhet shkruar me *-jan* si *matjan*. Ky kriter duhej ndjekur edhe me prapashtesat *-ion, -iar, -ier*, që duhej të ishin, në bazë të parimit fonetik, *-jon, -jan, -jer: revolucion, misjon, milion, financjar*, (si dyjar, trijar, gomarjar), *karrocjer, kantjer, magazinjer, bankjer, portjer* etj.

Mirëpo të hequrit e të vënët e *j-së* s'mbaron me kaq: «Rregullat» kthehen prapë te parimi fonetik me mbaresën *-jot: himarjot, nartjot, kaninjot* me *j*; megjithëse s'është shprehur për fjalët e huaja, sigurisht propozohet mbaresa *-iot* p.sh. *stradiot, qipriot*, po harrojmë se edhe *Kastriot*, nën ndikimin e fjalëve të huaja pa qenë i huaj, është shkruar pa *j*, veçse në gojë të popullit shqiptohet *Kastrijot*.

Problemi i takimit të shkronjave *g, n* me *j-në* i shkronjave *d, s, z, t*, me *h-në*, kur çdo shkronjë është tingull më vetë, është zgjidhur keq; zgjidhja e parë me *i* në vend të *j-së* si në *lagje, lënie* ishte më e drejtë, por linte pa zgjidhur çështjen e grupeve *d-h, s-h, z-h* dhe *t-h*. Kujtoj se është fobia e shenjave diakritike që i ka bërë «Rregullat» të krijojnë vështirësi të reja për lexuesit dhe shkruesit; në frëngjisht për të lexuar veçmas grupet e zanoreve *ai, oi, ou*, mbi shkronjat *i* dhe *u* vihen dy pika, që quhen *tréma (aï, oï, uï)*. Unë mendoj se një gjë analoge mund të bëhej në shqipe përsa i përket takimit të bashkëtingëlloreve të sipërme; kur duam t'i përdorim ndarë grupet *gj, nj, dh, sh* dhe *th* mund të përdorim dhe në një pikë mbi shkronjat *g, n, s, z, (g, n, s, z)*, dhe po një pikë nën shkronjat *d* dhe *t (d, t)*, kështu mund të shkruajmë *lagje* për ta dalluar nga *lagje* (mëhallë), *thënje, meshollë, sandhi, Miçhat* etj. (CII, § 3, § 4, f. 49, 50).

Edhe drejtshkrimi i fjalëve *ambicie, arie* s'na duket me vend; ose duhet shkruar me theks *ambície, árie*, ose me *j ambicje, arje*; analogjia me rasën gjindore të pashquar të fjalëve si *Shqipërie, bukurie, fëminie* etj. të bën që t'i lexosh vetiu *ambicie, arie*. Parimi fonetik, goja e popullit, këto fjalë i siveton (asimilon) në të shqiptuar me fjalë si *dalje, kapje*, pra s'ka asnjë arsye pse t'i shkruajmë sipas drejtshkrimit të italishtes *ária*. Një arsye tjetër për të shkruar *arja, arje, ambicje, ambicja*, me *j*, është dhe kjo: në shqipe shumica e emrave, në trajtën e tyre më të thjeshtë, në emëroren e pashquar njëjës, theksohen rëndom

në të parafundit: *dorë, letër, kopër, dalje, hyrje, vetull, numër* etj. prandaj, për t'i theksuar në mbi *a*-në, duhen shkruar me *j*. Kur u dashka shkruar *ambicie, arie*, po Sofje, Sofja përse shkruhet me *j*, nuk ndodhemi vallë përpara të njëjtit fenomen fonetik? Apo *-ie, -ia* e marrin vetëm emrat italianë dhe jo ata bullgarë! (Ç. §1, f. 51).

Nga një anë *Laokooni*, nga ana tjetër *Karonti*¹. Në analogji me *Laokoonin*, duhet thënë *Ksenofoni* apo *Ksenofonti*, *horizoni* apo *horizonti*? Kjo kategori emrash duhet marrë, jo nga emërorja, po nga rasat e tjera, ose më mirë nga kallëzorja, siç ndodh me emrat latinë, që kanë hyrë në shqipe: *qytet nga civitatem, shëndet nga sanitatem* etj. Më drejt është të shkruhet *Laokoonti*. (Ç. § 1, pika 9, f. 54).

Deri sot është thënë *Ilotët*. Përse pra *Helotët*? Edhe enciklopedia e vogël sovjetike e ka ИЛОТ до të jetë marrë nga gjermanishtja nëpërmjet ortografisë greqishtë *Ἰλωτες* (Ç. §1, pika 14).

Jo *psaltir* po *psalter*, siç është bërë edhe me emra të tjerë ku gr. *η* është bërë e *si* në *krestomaci* (Ç. §1, pikat 16, 19, f. 58, 59).

Fjala *taracë* kërkohet të shkruhet me *rr* sipas etimologjisë, sipas italishtes; përdorimi i sotëm i fjalës dhe dëshmia e fjalorit të Kristoforidhit provojnë se fjala shqipe s'ka dy *r*, por një; atëhere ose italisht, sipas etimologjisë *terracë*, ose ashtu si thohet *taracë* (Ç. § 1, pika 21, f. 60).

Në emrat e veçantë të njerëzve e të popujve, në emrat gjeografikë e mitologjikë grekë herë përdoret drejtshkrimi sipas latinishtes (saracenët, Cikladet, cikloni, centauri), herë drejtshkrimi sipas greqishtes (Gadishulli kalkidik). Do të ishte më mirë që emrat e veçantë grekë të shkruhen në përshtatje me fonetikën shqipe, sipas kriteresh të përcaktuara shprehimisht një herë e mirë. Në analogji me fjalë të tjera greke që kanë hyrë në shqipe si *qefull, qefali, qitro, Saraqinishtë* etj. do të ishte më mirë të shkruanim *qiklopi, qentauri, Qikladet, Kalkidika, Qefalonia, Maqedonia, Saraqenët* dhe jo me *c* si *Cikladet, ciklopi* etj. Do të ishte më mirë dhe më afër shqiptimit të derisotëm që Θ greke të jepej në shqipe me *th* në emrat e përveçëm siç e kanë edhe Rilindasit; kështu, mendoj unë, do të thonim më mirë *Athina* (jo *Athina*), *Theba, Thraka, Thesalia, Thanasi, Themistokleu* etj. Me kriteret e caktuara mirë e pa përjashtime, do të ishim në gjendje të transkriptonim në shqip çdo emër të përveçëm nga greqishtja edhe në rase që s'përmenden në «Rregullat» nuk do t'i riprodhonte secili sipas mendjes së vet nga gjuhët e huaja që di vetë. Këndej del nevoja që «Rregullat» të kenë edhe një pasqyrë për transkriptimin konvencional të alfabetit grek e latin me shkronja shqip për emrat e përveçëm.

Emrat e përveçëm të huaj të njerëzve e të vendeve, thonë «Rregullat» do të shkruheni përgjithësisht sipas shqiptimit që kanë në gjuhët përkatëse. Duhet shtuar: *kur është fjala për gjuhët e gjalla*.

Emrat e lashtë greko-latinë, të cilëve s'u dihet mënyra e shqiptimit e përpikët, duhet të shkruhen sipas një mënyre konvencionale si u tha më sipër. Mirëpo emrat e njerëzve e të vendeve që përdorin alfabetin latin (gjuhë të gjalla), dhe që u dihet shqiptimi në gjuhët përkatëse, nuk mund e nuk duhet të shkruhen sipas shqiptimit për arësyet që vijojnë:

Shkrimin e këtyre emrave të huaj sipas shqiptimit e bëjnë natyrisht vetëm me përafëri, gjuhët që kanë alfabetet të ndryshme nga alfabeti latin si rusishtja, greqishtja, gjeorgjianishtja etj. Duke u nisur nga kjo zgjidhje nevojë, dhe duke pandehur se këto gjuhë riprodhojnë me të vërtetë shqiptimin e atyre emrave me tingujt e gjuhëve nga janë marrë, edhe «Rregullat» fusin në shqipe parimin

1) *Karonti* është sipas latinishtes; sipas greqishtes mund të shkruhet edhe *Karoni* (χαρων, χάρωνος), sepse s'ka *t* në gjindore.

«shkruaj si shqiptohet». Gjuhët pa alfabet latin e bëjnë këtë nga e keqja, nga halli, dhe duan s'duan e shformojnë shqiptimin e vërtetë të këtyre fjalëve; kështu rusët Homerin e quajnë *Gomer*, Hygo-në *G-jugò*, Hertz-in *Gerc*, shqiptime këto që janë shumë larg së vërtetës; grekët shkrimtarit anglez *Byron* i thonë *Viron*.

Parimi «shkruaj si shqiptohet» duhet të zbatohet në shqipe nga e keqja, vetëm për gjuhët që nuk kanë alfabet latin, d.m.th për emrat rusë, grekë, gjeorgjianë, kinezë etj., por duke e formuluar parimin kështu: «t'i shkruajmë përafërsisht ashtu si shqiptohen në gjuhë të vet». Shqipes, me gjithë 36 tingujt që ka, i mungojnë shumë tinguj të gjuhëve të tjera; ne s'kemi tingujt *x* dhe *ы* të rusistes, *ch* dhe *ö* të gjermanishtes, *γ* dhe *χ* të greqishtes së re dhe të vjetër. Pra, sa herë që i shkruajmë emrat e huaj, gjasme me shqiptimin origjinal, më të shumtën e herës gënjejmë vetveten, sepse i shformojmë, i shtrembërojmë; kur shkruajmë *V. Hygo* (një e keqe tjetër se s'u caktojme dot as vendin e theksimit, sepse shqipja s'përdor theksa) përziejmë dy parimet; këtë fjalë e shkruajmë me *h* si në frangjisht, këtu mbajmë parimin e ruajtjes së formës; shkelim nga ana tjetër parimin fonetik, sepse këtë *h* e shqiptojmë, kurse ajo nuk shqiptohet; në frëngjisht kjo fjalë shqiptohet *Ygò*; *Bethoven* gjithashtu s'i përgjigjet shqiptimit të fjalës gjermane; edhe te fjala frënge Monteskjé, ë-ja edhe e theksuar nuk riprodhon tingullin *eu* të frëngjishtes; veç kësaj s'kemi ë të theksuar që të shkruhet në shqipet. Problemi ndërlikohet për gjuhët që s'i dimë, se s'ka mundësi të dimë shqiptimin e gjithë alfabeleve latine në çdo gjuhë. Mund ta marrim vërtet shqiptimin nga ndonjë gjuhë tjetër që e riprodhon këtë shqiptim, po edhe këtu do të gabohemi, se do të riprodhojmë një shqiptim të përafërt, duke i shtuar edhe shtrembërimet e fonetikës dhe të alfabetit tonë.

Atëhere çfarë zgjidhje do t'i japim problemit? Praktika ndërkombëtare këtë problem e ka zgjidhur. Gjithë gjuhët me alfabet latin emrat e përveçëm, kryesisht mbiemrat (llagapet) i shkruan pikë për pikë si në gjuhë të vet. Edhe banka jonë s'e paguan një çek, ku emri i të huajit të jetë shkruar si e shqiptojmë ne, po krahason emrin e çekut me emrin e pashaportës. Të huajt emrat e personaliteteve shqiptare i shkruajnë shqip, kurse shqiptimin rrallë herë e kam dëgjuar të riprodhohet si duhet. Gjeografitë e huaja emrat e vendeve dhe të qyteteve shqiptare i shkruajnë shqip: Durrës; Shkodër, Tirana ose Tiranë, Shkumbi etj. sikur të dinin shqip. Zyrat tona telegrafike s'pranojnë adresa telegramesh me emra vendesh të shkruara sipas shqiptimit. Edhe praktika e deritashme e revistave tona në gjuhë të huaj ndjek tjetër praktikë; në këto revista emrat e personaliteteve shqiptare nuk shkruhen si do t'i shqiptonte shqip i huaji, po i shkruajmë thjesht shqip, pa u shqetësuar në se ai do t'i shqiptojë mirë a keq. Si konkluzion logjik del se ne guxojmë të shtrembërojmë gjithë emrat e botës, po emrat tanë s'durojmë të na i prekin. Po të prananim reciprocitetin, emrat e personaliteteve shqiptare do t'i shkruanim ndryshe në italisht, ndryshe në frëngjisht etj. Le të marrim me mend përpara çfarë pështjellimi do të ndodheshim sikur çdo gjuhë emrat e njerëzve dhe të vendeve të huaja t'i shkruante secila sipas alfabetit të vet! Emrat e njerëzve në formën e tyre origjinale shprehin me anë shenjash grafike, si të thuash, një anë të personalitetit të tyre. Prandaj mendoj se emrat e përveçëm të gjuhëve të gjalla që përdorin alfabetin latin nuk duhet të preken, po t'u vemë në kllapë herën e parë shqiptimin e përafërt shqip. Këta emra nuk kapin më tepër se 3-400 emra historikë, gjeografikë dhe mitologjikë; për shkollat e mesme le të jetë edhe kjo një farë stërvitje e dobishme për kujtesën e fëmijëve. Lakimi i këtyre emrave mund të bëhet me ndarjen e mbaresave të lakimit me vizën lidhëse: *Rousseau-i* ose *filozofi Rousseau*, *Bordeaux-ja* ose *qyteti Bordeaux* (Bordó). Siç shihet, duke u shtuar këtyre emrave një karakteristikë (titull, emër të përgjith-

shëm), mund të mënjanohet edhe nevojën e lakimit, kur ky lakim e shtrembëron tepër shqiptimin e tij. Natyrisht disa emra njerëzish e vendesh do të marrin një shqiptim dhe trajtë tjetër kur janë emra që kanë hyrë në gjuhën popullore, si Venetik, Itali, Trieshtë, etj. (Ç, §2, f. 61, 62).

Kriteri fonetik i shkrimit të emrave të huaj është i lidhur me gjendjen e sotme të nivelit arësimor e kultural të masës së gjerë të popullit. Po, po të nisemi nga fakti që në të ardhmen ky nivel arësimor e kultural do të rritet si në sasi dhe në cilësi, kjo nuk mund të jetë një arësye vendimtare.

«Mbiemrat që përcaktojnë emra me shumësin në e do të përdoren në trajtën e gjinisë femërore»; kësaj rregulle i duhet shtuar: *kur këta emra nuk tregojnë frymorë* (BI, § 10, pika 9, f. 19, 20). Shembullat për ilustrimin e rregullës janë dhënë vetëm me mbiemra cilësorë si *bisedime paqësore, vendime të prera, personalitete të larta* etj. Duheshin dhënë edhe shembulla me mbiemra përcaktorë, p.sh. *ato brigje, ato male janë të mbuluara të dyja me dëborë gjatë dimrit*. Emrit *element* i janë dhënë dy trajta shumësi; do të shkruajmë *elementë*, me ë, kur flasim për frymorë, p.sh. *elementë të rrezikshëm*; por *elemente kimike*, se këto s'janë frymorë. Shpesh shkruhet e flitet *elemente të rrezikshme* (për njerëz) dhe *personalitete të larta* gjë që përbën një lëkundje që të vret veshin. I lehtë, i kuptueshëm e pa përjashtim është akordi i përsosur: emrat mashkullorë, qoftë në njëjës, qoftë në shumës, i duan mbiemrat në gjininë mashkullore: *male të lartë, elemente të rrezikshëm, elemente kimikë, personalitete të lartë, talente të shquar* (DI, §4, f. 63).

Dallimi i ndajfoljes *njëherë-dikur*, nga *një herë*=jo dy-tri herë, sa herë që shkruajmë, kërkon një analizë; ky dallim është formal; po t'i shkruajmë ndarë këto fjalë në dy frazat që japin «rregullat», askush nuk ngatërrohet: *na ishte një herë një plak dhe lejohet vetëm një herë*; i tillë është rasti edhe me që kur dhe qëkur, nga se dhe ngase, se ç' dhe seç, se sa dhe sesa, se ku dhe seku etj. Është më mirë t'ja lëmë kontekstit funksionin e dallimit, sesa një analize të vështirë, ndaj këtu e bashko atje; ndarja, si ç'e thamë edhe më sipër, nuk e ngatërron kuptimin e frazave: *Kjo punë ka që kur* dallohet nga kuptimi nga fraza që *kur ra shi, u ftoh moti ose nga kam që kur që po të pres*. Po kështu nuk erdhi ngase *s'kish kohë* është e barabartë me *nuk erdhi se s'kish kohë*, pra edhe *nuk erdhi nga se* (ndarë) *s'kish kohë*. Nëse është trajtë e shkurrtuar e lidhëzës në *qoftë se*, që shkruhet *damas*, pra edhe në *se* mund të shkruhet *damas*; nuk ka asnjë keqkuptim në dy frazat e dhëna si shembull: *në se nuk vjen, më shkruaj dhe në se qëndron ndryshimi midis A-së dhe B-së*. Po kështu *seç këndon bilbili* është një me *ç'këndon bilbili* pra edhe se *ç'këndon bilbili*, që dallohen nga shprehjet *s'di se ç'i ka ngjarë atij* = *s'di ç'i ka ngjarë atij* etj. Po këtë vështirësi artificiale paraqesin edhe *se si* dhe *sesi, se kur* dhe *sekur* etj. Qoftë kur janë ndarë, qoftë kur janë bashkë *se-ja* mund të hiqet pa e prishur kuptimin, pra edhe mund të ndahet, pa i vënë njerëzit përpara nevojës së një analize për të ndarë e për të bashkuar fjalë, që s'kanë nevojë të bashkohen aspak (DH, §1, shënimet 1, 2, 3, 4, f. 70, 71).

Që numërorët rreshtorë me shifra romake nuk duan prapashtesa, kuptohet, por pa nyjë nuk është e drejtë; në qoftë se në të folur në emërore halet nyja dhe themi *Kongresi* (i) *pestë*, në rastet e tjera nyjet *e, të, së* duhen shkruar; për shkrimin dhe përsëritjen e nyjeve «Rregullat» ngulin këmbë shumë. Duke i hequr në shkrim në këtë rast, tërthorazi përligjim shprehje si *Pallati Kulturës, Luigjin XV (Luigjin pesëmbëdhjetë)* në vend të shprehjes korrekte *Luigjin e XV, L. e pesëmbëdhjetë* (E, §2, shen. 1, f. 75).

Për thjeshtim dhe lehtësim, lidhur me rregullat e përdorimit të shkronjave të mëdha (Kapitulli II), mendoj që paragrafët 10, 11 duhet të bashkohen. Përse *Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve* të gjitha fjalët më të mëdha dhe *Biblio-*

teka *krumbëtare*, fjala e dytë me të vogël; nga një anë *Ndërmarrja bujqësore shtetërore* «Gjergj Dimitrov» dhe nga ana tjetër NBSH, që do të thotë *Ndërmarrja bujqësore shtetërore*. Thjeshtimi i rregullës kërkon të gjithë emrat e institucioneve shtetërore të shkruhen me të madhe; e aq më fort ato që kanë edhe trajtimin e tyre të shkurtuar me shkronja të mëdha (E, §10, f. 83, 84).

Edhe shkrimi i emrave gjeografikë më duket i ngatërruar; shenimi 1 e ngatërron punën, sepse s'është formuluar mirë dhe prandaj edhe shembullat s'janë në pajtim me sa është thënë më sipër. Ajo rregull duhej shprehur kështu: Kur emri i përgjithshëm gjeografik si *det, ishull, lumë, majë, vargmal, kanal* etj. nuk i shton gjë një emri të përveçëm gjeografik, pra kur është sinonim me të, shkruhet me të vogël; p.sh. *deti Adriatik-Adriatiku; ishulli i Sazanit-Sazani; kepi i Rodonit-Rodoni*, prandaj edhe me shkronjë të vogël; por *Korfuzi* është qytet dhe ishull, prandaj *Kanali i Korfuzit* duhet shkruar me të madhe; Suezit është qytet, *Kanali i Suezit* është tjetër gjë, prandaj edhe me të madhe.

Duhet shtuar gjithashtu se emrat gjeografikë, qofshin të thjeshtë, qofshin të përbërë, nëpër harta duhet të shkruhen kurdoherë me të madhe.

Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit është parashtruar mirë, po të mos ishin dhjetë faqet me shembulla të cilat në vend të sqarojmë e të plotësojmë rregullat, i ngatërrojmë fort njerëzit; bashkë me rregullat duhej bashkuar edhe shënimi i fundit i faqes 85; mund të shtohesh edhe se grupet *mb, nd, ngj, ng* të mos ndahen.

Shtyllat e faqeve 86, 87, 88 ngatërrojnë fort; s'ka asnjë arësyje që *kubla* të ndahet doemos *ku-bla* dhe jo *kub-la*; në rusisht ndahet fare mirë *би-тва* dhe *бит-ва, шум-ный* dhe *шу-мный*; në një mori rasash është ndarë radikali a rrënja e fjalës, që shpesh është bërë edhe si rregull, kështu u dashka ndarë doemos *lu-kthi* dhe jo *luk-thi*; në *luk* është rrënja, në shqipe ka plot fjalë që fillojnë me *thi-* sikurse edhe *kthi-*; nuk them të zbatohet doemos shtylla e ndaluar, po mendoj se me fare pak përjashtime, të dyja mënyrat e ndarjes janë të mundura dhe të lejueshme; kështu edhe *bler-je* edhe *ble-rje, shir-je* edhe *shir-je, das-më* edhe *das-më, velen-xë* dhe *velenxë*.

Shembullat e faqeve 89, 90, 91 mund të përmblihdeshin në tri a katër, sepse ndarja e dytë shkel rregullën e dhënë në shënimin e faqes 85.

Në shtyllat e faqes 94 (F. §3, pika 6) fjalët duheshin ndarë plotësisht në rrokje dhe jo vetëm më dysh. Detyrimi që fjalët e përbëra duhen ndarë doemos sipas pjesëve përbërëse, krijon vështirësi sidomos për fjalët e huaja; do të mjaftonte vetëm rregulla e ndarjes sipas rrokjeve; kështu *mos-ardhje* po, por edhe *mosar-dhje* ose *mos-ardh-je*; këtë rregull frëngjishtja s'e ka; në «Dictionnaire étymologique de la langue française» të O. Bloch et W. v. Wartburg gjejmë *expli-cation, dialect-tes, subs-tantivement, circons-tance* etj. Po aty pika 8, f. 95 ndalohet ndarja e një zanoreje në krye të fjalës edhe kur formon rrokje më vete; edhe kjo është një vështirësi e krijuar kot, sa për të prishur rregullën e vënë në fillim, d.m.th. ndarjen e fjalëve në rrokje; doemos *aca-rim*, përse jo edhe *a-ca-rim*; përse fjalët *erë, arë, afër, miu* etj. s'u ndakan, gjersa janë dy-rrokëshe; unë mendoj, dhe është afër mendjes, se mund të ndahen fare mirë: *a-rë, e-rë, a-fër, mi-u, li-ri-a* etj. në pajtim me këtë gjejmë në frëngjisht, në fjalorin e mësipërm dhe në Larousse plot ndarje zanoresh në fillim të fjalës, si *A-ristote, a-près, é-toffe, o-livier, ai-mant, ou-trepasser, ou-vrier, ai-mable, au-tant* etj.

Me këto që thamë jemi mundur të provojmë se drejtshkrimi i shqipes mund të ishte më i thjeshtë, d.m.th. më popullor, duke pasur më pak rregulla dhe më pak përjashtime. Prirja për krijimin e një drejtshkrimi që të pasqyronte gjuhën letrare të përbashkët është shkelur disa herë, p.sh. në ruajtjen e trajtës *-ua* (pakua, radiua etj.), te *nj-ja* në trup e në fund të fjalës (finjë, shkronjë,

arinj, barinj, ftonj etj.). Mua më duket se «Rregullat» disa vështirësi sikur i kanë krijuar vetë, duke i bërë këto rregulla herë shumë të shtangëta, herë shumë të lira, me kuptimin që krijojnë shumë përjashtime pa vend. Vende vende i bëhen ca lëshime stilistikës (për arësye stilistike...); nuk e kuptojmë nëse është fjala për prozën apo për poezinë. Këndeje del nevoja që në fund, në vijë të përgjithshme, të caktoheshin duersat (tolerancat) të paktën për poezinë. Apo «Rregullat» u japin liri të plotë poetëve të shkruajnë si të duan, dhe prozatorët i shtërngojnë, si të thuash, në pranga?

Meqë disa rregulla drejtshkrimi janë përndarë atëherë këndeje, nuk do të ishte keq që «Rregullat» të përmbanin edhe disa pasqyra lakimi emrash, mbiemrash, përemrash dhe të ndonjë zgjedhimi.

Pas dy projekteve të propozuara më parë, shihet qartë se me këtë projekt të fundit po shkojmë drejt një drejtshkrimi shumë a pak të njëjësuar dhe në vijë të përgjithshme të ngulitur. Diskutimi masiv që po zhvillohet në të gjithë vendin do të ndihmojë t'i jepet sigurisht një zgjidhje e drejtë gjithë çështjeve të drejtshkrimit tonë. Këto vërejtje, mendojmë, bashkë me diskutimet e tjera, do t'i japin rast një rrahjeje të vlefshme mendimesh lidhur me drejtshkrimin, për të ardhmen e bukur të gjuhës dhe të arësimit tonë në këtë fazë të revolucionit tonë kultural.

LIRAK DODBIBA